



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029
E-mail: kmdl原因@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

KMDLNj viziton rektorin e UP “Hasan Prishtina” , z. Marjan Dema

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë me datë 25.10.2017 ka vizituar rektorin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” , z. Marjan Dema.

Rektori Dema e ka informuar KMDLNj –në për veprimet e deritashme për realizimin e programit të stabilizimit të gjendjes në këtë Universitet duke shprehur optimizëm se zhvillimet do të shkojnë drejtë përmirësimit për çka i duhet kohë dhe ndihma e të gjithë atyre që ia duan të mirën Universitetit “Hasan Prishtina”. Gjithashtu , rektori Dema si problem e sheh mungesën e stafit administrativ ku gjithësej janë 340 punëtorë administrativ e që është numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që i vijojnë studimet në Universitetin e Prishtinës. Si shqetësim tjetër i rektorit Dema ishin edhe vizitat e shpeshta të cilat bëhen nga Policia e Kosovës, Inspektorati i Punës dhe Inspektorati i Arsimit që bëhen për verifikimin e vërtetimeve që lëshohen nga stafi i U.P. e që po e dëmton imazhin e Universitetit. KMDLNj nuk e vë në dyshim angazhimin e Policisë së Kosovës , Inspektoratit të Punës dhe Inspektoratit të Arsimit në rast se ka shkelje ligjore por është kundër instrumentalizimit të tyre për shkaqe politike dhe të tjera që e pengojnë dhe kompromitojnë Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina “.

KMDLNj ka informacione se presionet bëhen shkak se është pamundësuar kualifikimi apo gradimi i një zyrtari përkundër procedurave dhe kriterëve të parapara sikur edhe një kandidateje tjetër.

Rektori na pohoi që regjistrimet e studentëve kanë kaluar pa probleme dhe se fillimi i vitit studentor ka filluar me kohë dhe në rregull.

Është vendosur një rregull në procesin e gradimeve duke marrë për bazë vetëm kriteret profesionale e jo ato politike , partiake , nepotiste etj.

Mungesa e stafit akademik në ligjerata dhe provime është shumë më e vogël se viteve të kaluara.

Është siguruar një transparencë shumë më e madhe se më parë.

KMDLNj gjatë vizitës identifikoi këto problemet të cilat , nëse nuk eliminohen vetëm se do ta përkeqësojnë punën e U.P.

KMDLNj mendon se duhet :

- Përkundër rënies së ndikimit politik në vendimarrje, KMDLNj insiston të pamundësohet ndërhyrja dhe ndikimi politik në punët e Universitetit që ka qenë e theksuar dhe përcaktuese në punën e Universitetit deri më tani dhe për pasojë ka pasur politizimin e skajshëm , uljen e kriterëve dhe rënien e cilësisë së ligjërimit dhe mësimnxënies;

- Pavarësi e Universitetit nuk ka alternativë dhe ajo duhet të mbrohet nga studentët , profesorët , shoqëria civile duke identifikuar rastet konkrete të ndërhyrjes së politikës
- Duhet t'u pamundësohet profesorëve të rregullt të UP –së të ligjërojnë në Kolegjet private sepse ky angazhim konsiderohet dhe është konflikt i pastër interesi që në planin afatgjatë e rrënon kredibilitetin dhe cilësinë e UP –së.
- Duhet t'u pamundësohet atyre që mbajnë poste qeveritare dhe poste tjera të larta institucionale të mbajnë disa vende pune e sidomos nuk duhet lejuar të punojnë nëse nuk e plotësojnë kuotën e paraparë sikur që nuk duhet lejuar që ata të zëvendësohen me asistentët e tyre apo me asistentët e asistentëve siç ndodh shumë herë.
- Kriteret e përcaktuara sipas konkursit duhet të jenë ato që vendosin se kush do të pranohet e që statusi shoqëror , politik dhe ekonomik të favorizojnë kandidatë të caktuar në dëm të atyre që i plotësojnë kushtet. Në këtë kontekst MASHT duhet të jetë shumë i kujdesshëm në përcaktimin e kushteve të konkursit kurse Rektorati në zbatimin e drejtë dhe jodiskriminues të këtyre kushteve.
- Vendimmarrja në UP duhet të jetë transparente dhe duhet të monitorohet nga institucionet e pavarura.
- KMDLNj përkrahë fuqishëm të gjitha reformat dhe zhvillimet që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina “ pavarësisht nga kush udhëheqet dhe dënon çdo ndërhyrje politike dhe jopolitike të grupeve të interesit që e rrezikojnë pavarësinë e këtij institucioni më të lartë arsimorë që ka dhënë kontribut të madh në të gjithat proceset e kaluara në Kosovë , deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës.
- Degradimi akademik i Universitetit të Prishtinës ka ndodhur menjëherë pas përfundimit të luftës pasi UP ishte 100% nën ndikimin e politikës ndërsa tani ka filluar këndellja e që po pengohet nga ata që nuk ia duan të mirën universitetit dhe arsimimit cilësor si parakusht për zhvillim të gjithëmbarshtëm të shoqërisë.

25.10.2017
Prishtinë

Shërbimi për Informim